

VENDIM
Nr. 133, datë 22.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS
SHTETËRORE NR. 132/2026, “AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE ‘FONDI
PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME PËR VITIN 2026’”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.7.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, mori në shqyrtim kërkesën nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) e lidhur me vendimin nr. 132, datë 29.4.2026, të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të shoqëruar me formularin e njoftimit të AIDA-s, në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

I. Procedura

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me shkresën nr. 1312, datë 6.7.2026, ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e vendimit nr. 132, datë 29.4.2026, të Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSH), me qëllim përshtatjen e specifikimeve teknike të skemës me elementet zbatuese të VKM-së nr. 225, datë 1.4.2026.

2. Në kuadër të fillimit të fazës së zbatimit të skemës së mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) për vitin 2026, AIDA, në cilësinë e institucionit zbatues, ka kërkuar nga KNSH-ja rishikimin e vendimit nr. 132, datë 29.4.2026, “Për autorizimin e ndihmës shtetërore ‘Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026’”.

3. Në kërkesën e saj, AIDA ka parashtruar nevojën për rishikimin e disa zërave të shpenzimeve dhe intensiteteve të ndihmës, duke argumentuar se, për qëllime të zbatimit të skemës sipas VKM-së nr. 225, datë 1.4.2026, kërkohet një shtrirje më e gjerë e kostove të pranueshme. Specifikisht, AIDA ka kërkuar që krijimi i aplikacioneve dhe platformave të tregtisë elektronike, i trajtuar në vendimin nr. 132, sipas rregullave të ndihmës për investime (me intensitete 10% dhe 20%), të përfshihet në kategorinë e shpenzimeve korrente me mbulim deri në 100%, ashtu siç parashikohet në VKM-në nr. 225. Gjithashtu, është kërkuar përfshirja e kostove për ambalazhimin dhe etiketimin si kosto të mbulueshme, si dhe qartësimi i trajtimit të shërbimeve të konsulencës në kuadër të procesit të certifikimit të standardeve.

4. Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pas vlerësimit të kërkesës së AIDA-s, konstaton se vendimi nr. 132, datë 29.4.2026, është një akt administrativ i rregullt, i nxjerrë në përputhje të plotë me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi. Përcaktimi i intensiteteve të ndihmës (10%, 20% dhe 50%) dhe kategorizimi i shpenzimeve në vendimin e KNSH-së nr. 132/2026, pasqyrojnë tavanet maksimale të lejuara dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore për përputhshmërinë e skemave të mbështetjes me tregun e përbashkët. Për rrjedhojë, pretendimi i institucionit zbatues të ndihmës (AIDA) për ekzistencën e “mospërputhjeve” ligjore midis dy akteve nuk qëndron. VKM-ja nr. 225/2026 përcakton kriteret e përgjithshme të politikës për zhvillimin e biznesit, ndërsa vendimi i KNSH-së garanton që ky financim publik të mos cenojë konkurrencën, duke aplikuar rregullat e ndihmës për investime, ndihmës për konsulencë apo ndihmës *de minimis*, sipas natyrës ekonomike të çdo shpenzimi.

5. Megjithatë, duke vlerësuar se skema synon rritjen e konkurrueshmërisë së NMVM-ve dhe duke marrë parasysh vështirësitë teknike të evidentuara nga AIDA për administrimin dhe vlerësimin e aplikimeve brenda kufijve të vendimit të KNSH nr. 132/2026, analizon se kërkesa e AIDA-s mund të pranohet pjesërisht. Ky ndryshim nuk bëhet për shkak mospërputhjeje, por në funksion të harmonizimit teknik dhe fleksibilitetit procedural, duke rikategorizuar disa nga aktivitetet (si krijimi i platformave elektronike dhe proceset e ambalazhimit) nën instrumente të tjera të lejuara nga legjislacioni i ndihmës shtetërore (si rregullorja *de minimis* ose ndihmat për NMVM-të), pa cenuar kërkesat ligjore të vendimmarrjes së KNSH-së.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, 23 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

Kreu II, pikat 2 dhe 3, “Përshkrimi i masës” ndryshon si vijon:

“2. Qëllimi: Skema synon dhënien e përfitimit me fond nga buxheti i shtetit për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen e eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

3. Baza ligjore e planit të ndihmës: Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në pikën 2, të nenit 9, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” dhe VKM-së nr. 225, datë 1.4.2026, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026”.”.

Kreu III, pika 14, “Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore” ndryshon, si më poshtë:

“14. Plani i ndihmës ofrohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe financohet nga buxheti i shtetit përmes programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”. Vlera totale e skemës është 100,000,000 lekë. Prandaj, ndihma akordohet përmes burimeve shtetërore. Lidhur me përfituesit e ndihmës, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), skema parashikon mbulimin e kostove të miratuara deri në 100%, por jo më shumë se 2,500,000 lekë për një aplikues. Plani i ndihmës, ka në fokus rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit. Bazuar në këtë skemë, ndërmarrjet aktive në të gjithë sektorët e ekonomisë do të sigurojnë një avantazh ekonomik në formë e mbështetjes me grante direkte që do të mundësojnë uljen e kostove të tyre të prodhimit/shërbimit. Në këtë mënyrë ndihma ofron një avantazh ekonomik pasi lehtëson përfituesit nga kostot që do të duhej të përballonin në kushte normale tregu. Skema është selektive, pasi nuk është e hapur për të gjithë operatorët ekonomikë në treg, por vetëm për ndërmarrjet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” dhe që për zgjidhen si fituese nëpërmjet procedurës së aplikimit, bazuar në plane biznesi të fokusuara në nxitjen e eksportit dhe inovacionit. Skema në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të shtrembërojë ose të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën, pasi forcon pozicionin në konkurrencë të përfituesve të saj në tregun vendas dhe ndërkombëtar.”.

Kreu IV, pika 15, Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës, ndryshon si më poshtë:

“15. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndhimja *de Minimis*” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Mbështetur në kreun II të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës *de minimis*”, ndihma lejohet nëse përmbushen njëherazi kushtet e mëposhtme:

- Vlera totale e ndihmës për një ndërmarrje të vetme nuk tejkalon 14,000,000 lekë gjatë një periudhe prej tre viteve financiare;

- Ndhimja është transparente dhe ekuivalenti bruto i grantit mund të llogaritet përpara dhënies së saj.

Në rastin konkret, këto kushte plotësohen në nivel skeme pasi ndihma individuale maksimale nuk e kalon vlerën 2,500,000 lekë, kohëzgjatja e skemës është e kufizuar brenda vitit buxhetor 2026, dhe ndihma jepet në formën e grantit direkt (ndihmë transparente).

Megjithatë, duke qenë se skemat e mbështetjes së AIDA-s janë të përvitshme dhe ndërmarrjet mund të përfitojnë nga burime të ndryshme të ndihmës shtetërore, përmbushja e kërkesës për respektimin e tavanit ligjor prej 14,000,000 lekësh për çdo përfitues sigurohet nëpërmjet detyrimit të AIDA-s për të kryer verifikimin paraprak të ndihmave që ka përfituar secili aplikues (nëpërmjet vetëdeklarimit me shkrim dhe bazës së saj të të dhënave) përpara nënshkrimit të çdo marrëveshjeje granti. Përgjegjësia për respektimin e tavanit ligjor trevjeçar *de minimis* gjatë zbatimit të skemës është e AIDA-s në cilësinë e zbatuesit të skemës.”.

Pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5, të vendimit të KNSH-së nr. 132, datë 29.4.2026, ndryshojnë dhe zëvendësohen si më poshtë:

“1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026”, si masë ndihme “*De Minimis*”, të miratuar me VKM-në nr. 225, datë 1.4.2026, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026”.

2. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e autoritetit zbatues, detyrohet të sigurojnë që përpara nënshkrimit të aktit të akordimit (kontratës së grantit), çdo ndërmarrje përfituese të paraqesë një deklaratë zyrtare me shkrim mbi çdo ndihmë tjetër *de minimis* të pranuar gjatë dy viteve të mëparshme financiare dhe vitit financiar në vijim nga AIDA apo nga çdo dhënës/autoritet tjetër shtetëror, duke garantuar që shuma totale e përfituar e ndihmave të mos kalojë tavanin prej 14,000,000 lekësh.

3. AIDA detyrohet të mbajë një bazë të dhënash të brendshme me informacionin e plotë për çdo ndërmarrje përfituese dhe të njoftojë zyrtarisht Sekretariatit e Komisionit të Ndhmës Shtetërore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, me qëllim monitorimin dhe përditësimin e të dhënave, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi për ndihmën shtetërore.

4. AIDA detyrohet që brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport pranë KNSH-së për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

5. Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni për zbatimin e skemës dhe ndihmën individuale të akorduar duhet të ruhen nga AIDA për një periudhë prej 10 (dhjetë) vitesh, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.”.

6. Ky vendim ndryshon vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 132, datë 29.4.2026.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari